



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2704, datë 22.12.2016

Për

“Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Sara Recic, në mbledhjen e datës 22.12.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira”

Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:

- Projekt vendimi
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit
- Dokumenti: *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse-Dokumenti Perfundimtar”*

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 55 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP (VKD) nr.2703, date 22.12.2016, “*Miratimin e dokumentit “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumice te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse – Dokumenti Përfundimtar”*”
3. VKD nr.2701, datë 22.12.2016, për “*Miratimin e dokumentit “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira- Dokumenti Përfundimtar”*”
4. VKD Nr.2702, datë 22.12.2016, për “*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira dhe masat përkatëse rregulluese*”
5. Rregullore Nr.9 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt-vendimi per “*Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira*”
2. Dokumenti: *Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse-Dokumenti Përfundimtar.*
3. Relacioni shpjegues për Projektvendimin (**Relacioni**).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtus i AKEP me Vendimin Nr. 2701, datë 22.12.2016, miratoi dokumentin “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti Përfundimtar*”, dhe me Vendimin Nr.2702, datë 22.12.2016, për “*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira dhe masat përkatëse rregulluese*”, ka përcaktuar Albtelecom sh.a sipërmarrës me FNT në tregjet përkatës të mëposhtëm:
 - a) Tregun me shumice te aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (WLA)

- b) Tregun me shumice te aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA)
 - c) Tregun me shumice te aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (WHQA);
2. Këshilli Drejtus AKEP me Vendimin nr.2703, date 22.12.2016, miratoi dokumentin “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse-Dokumenti *Perfundimtar*”. Ky dokument:
- a) është përgatitur në përputhje me nenin 55 të Ligjit 9918 pas procedurës së këshillimit publik dhe ka marrë në konsideratë komentet e dërguara nga palët e interesuara, dhe komentet kryesore dhe qëndrimi i AKEP për komentet është pjesë e tij (Aneks 2);
 - b) ka marrë në konsideratë praktikatat më të mira në vendet e BE dhe rajonit dhe kushtet e tregut Shqiptar;
 - c) është përgatitur në përputhje me përcaktimet në dokumentin “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira- Dokumenti Përfundimtar*”, miratuar me VKD Nr.2701, datë 22.12.2016, dhe përcaktimet e VKD Nr.2702, datë 22.12.2016, për “*Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira dhe masat përkatëse rregulluese*”;
 - d) përmban arsyetimin për metodat e rregullimit të tarifave me shumicë të Altelecom i përcaktuar me FNT me VKD Nr.2702, datë 22.12.2016.
3. Dokumenti “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse-Dokumenti Përfundimtar*” i miratuar me VKD nr.2703, date 22.12.2016, shërben si pjesë arsyetuese për marrjen e këtij vendimi për rregullimin e tarifave të Altelecom sh.a i përcaktuar me FNT me VKD Nr.2702, datë 22.12.2016.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Në përputhje me Nenin 57, pika 1/a e Ligjit 9918, metoda e rregullimit të tarifave të Altelecom sh.a i përcaktuar me FNT¹ në **tregun me shumice te aksesit ne nivel lokal ne**

¹ VKD nr.2702, date 22.12.2016.

vendndodhje fikse (WLA), është **përcaktimi i nivelit maksimal** sipas vlerave dhe afateve të mëposhtëme:

- a. Tarifat maksimale për aksesin e hapur në qarkun lokal

Tabela 1 : Tarifat me shumice te Altelecom per aksesin LLU

Shërbimi		1.07.2017 ⁻²
Tarifa Mujore		
Akses i plote në rrjetin lokal (LLU)-MSAN		556
Akses i perbashket në rrjetin lokal (LLU)-MSAN		334
Tarifa instalimi për LLU		
Instalimi I aksesit te plote ne rrjetin lokal		1,686
Instalimi I aksesit te perbashket në rrjetin lokal të hapur		2,452

Shenim: Tarifat ne LEK pa TVSH

- b. Tarifat maksimale për aksesin në tubacione në nivel lokal

Tabela 2: Tarifat Maksimale me shumice të Altelecom per aksesin ne tubacione ne nivel Lokal (1.07.2017-)

	Tarife Fillestare (Euro/km)		Tarifat Maksimale per akses ne tuba ne nivel lokal/urban		
	Distanca (Km)	Diametri (mm)	deri ne 10 mm+0.5	10-20 mm+0.5	20-30 mm+0.5
D1	<0.2	13,832	11,066	12,449	13,832
D2	0.2-5	11,066	8,299	10,097	12,449
D3	5-20	11,066	7,608	9,406	11,757
D4	20-40	11,066	7,193	8,852	11,066
D5	40-80	11,066	6,639	8,299	9,959
D6	80-160	11,066	6,086	7,746	9,406
D7	160-300	11,066	5,533	6,916	8,299
D8	>300	11,066	4,980	6,363	7,193

Shenim: Tarifat ne Lek³ pa TVSH

² Deri në një vendim tjetër të AKEP sipas përcaktimeve të nenit 55 e në vijim të ligjit 9918.

³ Tarifat aktuale te Altelecom jane ne Euro. AKEP ka bere konvertimin ne LEK, duke perdorur Kursin e Kembimit 1 Euro=138.32 Lek, i perdorur dhe nga BEREC ne dokumentin BoR (16) 218 “Termination rates at European level- July 2016” December 2016.

2. Në përputhje me Nenin 57, pika 1/a e Ligjit 9918, metoda e rregullimit të tarifave të Albtelcom sh.a i përcaktuar me FNT⁴ në **Tregun me shumice te aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA)** është:

a. **përcaktimi i nivelit maksimal** sipas vlerave dhe afateve të mëposhtëme:

Tabela 3: Tarifat maksimale mujore te aksesit bitstream te Albtelcom (1.07.2017-)

	Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet		Opsioni 2: Bitstream ne IP	
	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta
Shpejtesia Doëload				
2 Mbps	382	345	450	405
4 Mbps	508	459	599	540
6 Mbps	625	566	738	664
8 Mbps	832	754	984	886
10 Mbps	898	812	1,059	954
12Mbps	990	894	1,169	1,052
16 Mbps	1,138	1,033	1,345	1,205

b. dhe **përcaktimi i nivelit minimal**:

Tarifat mujore të aksesit bistream të Albtelcom nuk duhet të jenë më të ulëta se 334 lek/muaj apo sa niveli i tarifës së aplikuar për shërbimin e aksesit të perbashkët në rrjetin local (LLU)-MSAN të Albtelcom.

3. Në përputhje me Nenin 57, pika 1/a e Ligjit 9918, metoda e rregullimit të tarifave të Albtelcom sh.a i përcaktuar me FNT⁵ në **Tregun me shumice te aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (WHOQ)**, është **përcaktimi i nivelit maksimal** sipas vlerave dhe afateve të mëposhtëme:

Tabela 4: Tarifat maksimale te linjave me qira me shumice te Albtelcom (1.07.2017-)

Shpejtesia e transmetimit te te dhenave	Tarifa e Instalimit	Tarifa Mujore	
		Per linje	per km
2 Mbps	4,905	13,735	267
34 Mbps	38,500	62,500	750
155 Mbps	43,000	125,000	1,500

Shenim: tarifat ne Lek pa TVSH

⁴ VKD nr.2702, date 22.12.2016.

⁵ VKD nr.2702, date 22.12.2016.

4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi ne daten e miratimit te tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Anila DENAJ
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI